



Denisa Mihallari

## Historia e një menaxhereje të re

Pas përfundimit të studimeve për Agro-ushqim në vitin 2014 në një prej universiteteve publike në Shqipëri, Denisa Mihallari, 24 vjeç, për afro dy vjet ishte në kërkim të një pune të përshtatshme. Një ditë, teksa ecte rrugëve të qytetit të Fierit, syri i kapi një poster që ja tërhoqi vëmendjen menjëherë: Shoqata Shqiptare e Marketingut në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit - zyrën e punës në Fier - njoftonin për një trajnim 6-mujor mbi shërbimet e marketingut në sektorin agro, që mundësohej me mbështetjen e projektit RisiAlbania.

**“Duke qenë pa punë në atë kohë, ky trajnim m’u duk si një shans që s’duhej humbur; e teksa bluaja në kokë detajet e posterit, këmbët instiktivisht më çuan drejt zyrës së punës në Fier, për të**

## The story of a young manager

Having completed university studies in food science at one of Albania’s public universities in 2014, Denisa Mihallari, 24, had been constantly job-seeking for almost two years, trying to find suitable employment. One day in 2015, walking through Fier’s busy streets, she spotted a poster that got her attention immediately. The Albanian Association of Marketing in cooperation with the National employment Service -Fier’s local labour office- were announcing a 6-month training on marketing services for the agro sector, an opportunity made possible with the support of RisiAlbania project.

**“Being jobless then, I knew this training was something for me. All the poster-details I read again and again, were**

**mësuar më tepër...”** - thotë Denisa. Ajo u regjistrua menjëherë si punëkërkuese e papunë dhe shprehu interes për trajnimin. Më pas u përzgjodh për të ndjekur fazën teorike të tij, që nisi në shtator 2015. Gjatë muajit të dytë të trajnimit, zyra e punës në Fier i ofroi Denisës një vend pune si shitëse në supermarket, të cilin ajo e pranoi ndërsa paralelisht vazhonte edhe trajnimin.

Pas përfundimit të fazës teorike të trajnimit, Denisa u përzgjodh edhe për fazën tjetër - trajnim në vendin e punës - që përfundoi në prill 2016. Nëpërmjet trajnimit teorik dhe praktik Denisa fitoi një sërë njohurish dhe aftësish të rëndësishme mbi standardet e cilësisë dhe marketingun, të cilat ajo i zbaton në punën e saj të përditshme në supermarket. Pas përfundimit të trajnimit 6-mujor, duke parë rritjen e aftësive dhe potencialit të saj, punëdhënësit e Denisës vendosën ta ngrenë në detyrë, duke i besuar menaxhimin e sektorit të bulmetit në supermarketin e tyre.

Hap pas hapi Denisa ka sjellë ndryshim në vendin e saj të punës; ajo ka arritur të prezantojë një mendësi tërësisht të re për mënyrën e marketimit dhe shitjes së produkteve të qumështit në supermarketin ku punon. Në kontakte e biseda me furnizuesit ekzistues të bulmetit, Denisa ju kërkoi atyre të aplikojnë sa më tepër paketimet me vakum për furnizimet e supermarketit, në përputhje me standardet e kërkuara, për të garantuar në këtë mënyrë sigurinë e konsumatorëve.

**“Kisha lexuar rreth standardeve në agro-ushqim përmes kurrikulave në universitet, por trajnimi nga Shoqata Shqiptare e Marketingut i ngriti**

**later buzzing in my head, and my feet instinctively pushed me towards the labour office in Fier to find out more...”**

- says Denisa. She got registered as an unemployed job-seeker and expressed interest in the training. Shortly after that she was selected to attend the theoretical part, which started in September 2015. During the second month of the training, the labour office in Fier found Denisa a job in a supermarket as a sales person, which she accepted while still attending the training.

At the end of theoretical part of the training, she enrolled for the on-the-job training phase, which finished in April 2016 and helped her acquire a lot of important skills and knowledge about the quality and marketing standards which Denisa applies in her day-to-day work. Seeing her increased skills and potential, Denisa's employers decided to promote her after completing the 6-month training: they entrusted her with the management of the dairy section of their supermarket.

Step by step Denisa has brought a change to her working place; she has managed to introduce a whole new concept how dairy products should be supplied and marketed. She started by negotiating with the existing dairy suppliers, asking them to vacuum pack the products they supplied to the supermarket in order to comply with the required standards and guarantee customers' safety and satisfaction. **“I had come across the agro-food standards during my university curricula, but the training provided by Albanian Association of**

**njohuritë e mia në një tjetër nivel, duke më mësuar se si t'i zbatoj praktikisht ato standarde në punën time të përditshme në supermarket. Une fillova t'i zbatoja fillimisht duke përzgjedhur vetëm furnizues të certifikuar për prodhimet e qumështit, çka ndikoi menjëherë në rritjen e besimit të konsumatorëve si edhe në shtimin e shitjeve”** - thotë Denisa, plot besim dhe pasion për punën që bën.

Përveç punës me kohë të plotë në supermarket, Denisa punon me kohë të pjesshme si përfaqësuese shitjesh për një kompani të madhe që prodhon dhe shpërndan patatina në qytetin e Fierit. Planet që Denisa ka për të ardhmen janë ambicioze: përveç ofrimit të shërbimeve të marketingut si konsulente e pavarur, Denisa shpreson që një ditë të jetë edhe sipërmarrëse. Ëndrra e saj është të ketë një serë të vetën, për të kultivuar produkte organike për familjen dhe qytetin e saj.

**Marketing took that knowledge a step further in teaching me how to practically apply those standards in my daily work at the supermarket. I acted by starting to select only certified suppliers for our dairy section, which immediately increased the sales and positively affected customers' satisfaction”** - says Denisa, full of confidence and passion for the job she currently does.

Besides her full time work in the supermarket, Denisa is involved part time as a sales representative for the city of Fier on behalf of a big company that produces and distributes a brand of potato chips. Her future prospects are ambitious: besides offering marketing services as an independent consultant, Denisa wants to become an entrepreneur someday. Her dream is to have a greenhouse of her own, where she can grow organic produce for her family and her city.

Trajnimi i Shoqatës Shqiptare të Marketingut për “Përmirësimin e Cilësisë dhe Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale të Shërbimeve të Marketingut në Sektorin Agro” rriti kapacitetet e 89 të rinjve e të rejave në Korçë, Skrapar dhe Fier, 56 nga të cilët (40% femra) përfunduan edhe fazën e trajnimit në vendin e punës. Trajnimi ju dha të rinjve mundësinë për të fituar dhe për të përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e tyre në fusha specifike të ekspertizës, të tilla si aksesit në treg, promovimi, standardet e cilësisë dhe certifikimi, brandimi dhe etiketimi, duke çuar në gjenerim më të madh punësimi përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të marketingut në sektorin agro në Shqipëri. Vetëm disa muaj më pas, 12 të rinj të trajnuar si Denisa, janë punësuar me kohë të plotë, ndërsa 9 të tjerë punojnë me kohë të pjesshme në ofrim shërbimesh marketingu për agro-përpunuesit.

The training of the Albanian Association of Marketing on “Improving the quality and developing local capacities for marketing services in the Albanian agro sector” raised the capacities of 89 young men and women in Korçe, Skrapar and Fier, 56 of whom (40% women) were able to complete the on-the-job training phase. Such training gave the youth the opportunity to gain and upgrade their skills and knowledge on the specific fields of expertise, such as market access, promotion, quality standards and certification, branding and labeling, leading to more employment generation through improvement of marketing services' quality in the Albanian agro sector. Only a couple of months after the training was completed, 12 trained young people like Denisa, were able to find full time employment, while 9 others are working part time offering marketing services to agro-processors.